



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

## Mbrojtja e të dhënave personale

### Ku qëndron problemi?

#### Çfarë është një e dhënë personale?

Çdo informacion që mundeson identifikimin e një personi: emri, një fotografi, një numër telefoni celulari, adresa IP-së e cila i përket kompjuterit tuaj ...

Të shumtë janë të rinjtë - jo të gjithë sigurisht - të cilët nuk e kanë problem të publikojnë jetën e tyre private në Internet. Të rinjtë duhet të ndërgjegjësohen se kjo hapësirë lirie nuk është një hapësirë pa te drejta dhe që interneti mund të shkaktojë gjithashtu dëme në jetën private.

Kjo fletushkë ju ndihmon të qartësoni disa koncepte të përgjithshme mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe ndikimin që mund të ketë përdorimi i tyre në jetën e të rinjve në moshat 12 - 17 vjeç.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.



## RRJETET SOCIALE PRIVATËSIA ËSHTË E SHENJTË

facebook

*Kur publikoni të dhëna personale si fotografitë, videot, numrin e telefonit celular në një rrjet social, ju humbisni kontrollin e tyre. Të dhënat personale mund të regjistrohen nga kontaktet tuaja, të ripunohen dhe të shpërndahen sërish.*

twitter

## BLOG: RRJETET SOCIALE & PRIVATËSIA

*A do të thotë kjo se pas 10 vitesh punëmarrësi i ardhshëm do të dijë se si e keni kaluar kohën tuaj të lirë?*

*Përdoruesit e blogut dhe të rrjeteve sociale rallë herë janë të ndërgjegjshëm se informacioni që ata vendosin sot, mund t'iu shkaktojë shqetësime në të ardhmen. Këto të dhëna, qëndrojnë të disponueshme nga motorët e kërkimit dhe në distancë vitesh.*

## PROFILET FALLCO, NJË TELASH I MADH!

*Çfarë mund të bëjmë nëse dikush ka hapur një profil të rremë në emrin tonë?*

*Nëse zbuloni se dikush ka publikuar një profil tuajin të rremë në një rrjet social, atëherë duhet t'i drejtoheni menjëherë administratorit të rrjetit me anë të një emaili ku të shpjegoni sa më thjesht se pse ai profil është i rremë. Kërkoni që dhe shokët tuaj të bëjnë të njëjtë gjë për ju në mënyrë që rasti juaj të merret në konsideratë sa më parë.*

LinkedIn

# You Tube™ & PËRGJEGJËSIA

A mund të publikoj  
çfarëdo filmimi që  
dëshiroj?

Regjistrimi i pamjeve filmike në klasë, shkollë apo dhe në jetën e përditshme duhet të bëhet në respekt të lirive dhe të drejtave të personave të përfshirë në të. Nëse dëshironi të publikoni një filmim, parë duhet të merrni pëlqimin e personave të përfshirë në të.

**SPAMET  
SI TI EVITOHJË?**

Kur ju publikoni adresën tuaj të emailit në një faqe interneti duhet të keni parasysh se ekzistojnë disa "fshesa" të cilat thithin adresën tuaj. Për të limituar spam-et është mirë të krijoni një adresë enkas për përdorim në faqet e internetit publike për këdo.

**GJURMËT: UNË LUNDROJ ANONIM!**

A mund të gjendem edhe  
pse nuk lë asnjë të dhënë  
personale në Internet?

Duhet ditur se lundrimi në Internet lë gjithmonë gjurmë (adresa IP-së, historiku i lundrimit, emrat kyç të kërkuar në motorët e kërkimit). Çdo klikim i juaji është një e dhënë që ju lini...  
Ju mund të fshiheni pas një pseudonimi po jo pas një adrese IP.

## Për të reflektuar ...

*A* duhet t'i bejme publike ne rrjet te gjitha fotografite tona?

*A* i njohim të gjithë "miqtë" e rrjetit në jetën reale?

*A* do te benit "mik" ne rrjet edhe prinderit?

*A* je i detyruar t'i pergjigjesh te gjitha pyetjeve te nje formulari?

*P* se te behen gjithe keto pyetje?



Për të mësuar më shumë:

[www.idp.al](http://www.idp.al)    [www.getnetwise.org](http://www.getnetwise.org)  
[www.staysafe.org](http://www.staysafe.org)    [www.staysafeonline.org](http://www.staysafeonline.org)